



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr. 03/L-040, (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 28, qershor 2008), nenit 27 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 25.5.2026, merr këtë:

V E N D I M
P Ë R

**RRITJEN E MJETEVE NGA TEJKALIMI I PLANIT PËR TË HYRA VETJAKE DHE
BARTJEN E MJETEVE NGA VITI 2025 NË VITIN 2026**

- MIRATOHET** - Vendimi për rritjen e mjeteve nga tejkalimi i planit të të hyrave vetjake dhe bartjen e mjeteve nga viti 2025 në vitin 2026.
- Sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet rritja e tejkalimit të planit të të hyrave vetjake dhe bartjen e mjeteve nga vitit 2025 në vitin 2026, në vlerë prej **10,811,713.15 €**.
- Mjetet nga të hyrave vetjake nga viti 2025, do të destinohen në kategoritë për:

3.1. <i>paga dhe shtesa – 110</i>	60,000.00 €;
3.2. <i>mallra dhe shërbime – 130</i>	6,560,208.88 €;
3.3. <i>investime kapitale – 300</i>	4,191,504.27 €;

Gjithsej: 10,811,713.15 €

3.1. *Paga dhe shtesa – vlera totale sipas nënprogramit 60,000.00 €*

3.1.1 Arsimi i mesëm i lartë – 94350 në vlerë prej 60,000.00 €,

3.2. *Mallra dhe shërbime – vlera totale sipas nënprogrameve 6,560,208.88 €*

- 3.2.1 Administrata – 16306 në vlerë prej 674,044.11 €,
- 3.2.2 Investimet kapitale dhe menaxhimi i kontratave – 18040 në vlerë prej 150,000.00 €,
- 3.2.3 Infrastruktura publike – 18166 në vlerë prej 4,298,924.07 €,
- 3.2.3 Shërbimet e shëndetësisë primare – 73350 në vlerë prej 243,000.00 €,
- 3.2.4 Shërbimet sociale – 75526 në vlerë prej 226,901.81 €,
- 3.2.5 Arsimi parashkollor – 92310 në vlerë prej 967,338.89 €,

3.3. *Investimet kapitale – vlera totale sipas nënprogrameve 4,191,504.27 €*

- 3.2.1. Administrata - 16306 në vlerë prej 169,000.00 €,
- 3.2.2. Shërbimet publike – 18039 në vlerë prej 74,462.50 €,
- 3.2.3. Investimet kapitale dhe menaxhimi i kontratave – 18040 në vlerë prej 2,452,981.77 €,
- 3.2.4. Infrastruktura publike – 18166 në vlerë prej 710,000.00 €,
- 3.2.10. Sporti dhe rekreacioni – 85086 në vlerë prej 285,060.00 €,
- 3.2.12. Arsimi fillor, i mesëm i ulët – 93150 në vlerë prej 500,000.00 €,

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është pjesa tabelare.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës dhe Drejtorja e Financave.
6. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e kryeqytetit.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-020/04-75279/26, më 25.5.2026

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina



Arsyetim

Mbështetur në Ligjin e menaxhimit të financave publike dhe përgjegjësi dhe Ligjin mbi buxhetin, nr. 10/L-001, neni 8, pika 7, organizatat buxhetore realizojnë të drejtën për bartjen e mjeteve si bilance të kontraktuara në vijueshmëri për realizim të projekteve kapitale.

Tejkalimi i planit për të hyra vetjake përfshinë vlerën e mbledhur mbi planin buxhetor dhe bartjen e mjeteve nga viti 2025 në vitin 2026, dedikimi i këtyre mjeteve sipas kategorive do të jetë;

- Kategoria e pagave dhe shtesave, kompensimin e mësimin joformal për shkollat profesionale për vitet 2025 - 2026, obligime të papaguara, në vlerë prej 60,000.00 €, gjithsej kategoria e pagave dhe shtesave 60,000.00 €;
- Kategoria e mallrave dhe e shërbimeve, janë obligime ndaj kontratave të hapura, obligime ndaj lëndëve të cilat janë krijuar shkak i aprovimit të vonshëm të buxhetit të vitit 2025 nga ana e Komunës së Prishtinës dhe në mungesë të komisionit për buxhet dhe financa në Kuvendin e Kosovës për aprovimin e buxhetit të rregullt për vitin 2025 për Komunën e Prishtinës, obligime në vlerë prej 6,560,208.88 €;
- Kategoria e investimeve kapitale, janë obligime të mbetura ndaj kontratave të hapura, obligime ndaj lëndëve të cilat janë krijuar shkak i aprovimit të vonshëm të buxhetit të vitit 2025 nga ana e Komunës së Prishtinës dhe në mungesë të komisionit për buxhet dhe financa në Kuvendin e Kosovës për aprovimin e buxhetit të rregullt për vitin 2025 për Komunën e Prishtinës, obligime në vlerë prej 4,191,504.27 €.

Të bashkëngjitura janë në forma tabelare.

KRYESUESI I KUVENDIT

Fehmi Kupina

